



KCDE - Mëso Online
Kosova Center for Distance Education



ICEDA

Increasing Civic Engagement
in the Digital Agenda

MUNDËSITË E HUMBURA



**PROGRAMET
“NGA DISTANÇA”
DHE TË RINJTË/TË REJAT
ROMË,
ASHKALI
DHE EGJIPTIANË**



The project is co-funded by
the European Union



Foundation for Internet and Society



OPEN DATA KOSOVO



e-Governance Academy



PARTNERS
SERBIA



NGO 35 MM



MJAFI

The "Increasing Civic Engagement in the Digital Agenda – ICEDA" project is implemented by Metamorphosis Foundation (North Macedonia), Open Data Kosovo (Kosovo), e-Government Academy (Estonia), Partners for Democratic Change Serbia (Serbia), NGO 35 MM (Montenegro) and Lëvizja MJAFI (Albania).

Ky hulumtim është përgatitur si pjesë e projektit “Rritja e Pjesëmarrjes së Qytetarëve në Agjendën Digjitale – ICEDA” me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja është përgjegjësi e Kosova Center for Distance Education (KCDE) - Mëso Online, dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Informata mbi Autorët

Aaron Spitler
Hulumtues, KCDE aaron.spitler@kcde-ks.org

Antigona Uka
Drejtoreshë Ekzekutive, KCDE
antigona.uka@kcde-ks.org

Originali është shkruar në gjuhën Angleze në kuadër të projektit:
"Avokimi për integrimin digjital në sistemin arsimor: Forcimi i arsimit në distancë në Kosovë"

Implementuar nga:  **KCDE - Mëso Online**
Kosova Center for Distance Education

Kosova Center for Distance Education-Mëso Online
www.mesoonline-ks.org

Punim Udhëzues

Nxënësit në mbarë Kosovën hasën në vështirësi të përshtaten me “realitetin e ri” të shkaktuar nga pandemia COVID-19. Ndërsa shkollat po mbylleshin, politikëbërësit e kthyen vëmendjen drejt "mësimin në distancë", duke besuar se teknologjia mund t'i ndihmojë të rinjtë dhe të rejtat të vazhdojnë mësimet e tyre përderisa ata ishin të mbyllur. Mirëpo, të dhënat kanë treguar se jo të gjithë fëmijët kanë përfituar nga këto intervenime, siç janë personat që i përkisnin komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptianë. Të njëjtit u përballën me një sërë sfida, të cilat penguan shumicën prej tyre të kenë qasje në arsim; duke u nisur nga infrastruktura e papërshtatshme digjitale e deri tek njohuritë e kufizuara digjitale. Probleme të ndryshme bënë të pamundur adaptimin më të gjërë të teknologjive mësimore nga shkollat të cilat u shërbejnë kësaj pjese të anashkaluar të shoqërisë. Si rezultat, ekspertët e fushës kanë shprehur shqetësime të mëdha në lidhje me humbjen e mësimin që e përjetuan grupet të cilat historikisht njihen të margjinalizuara.

Më tutje, në situatën të cilën po ballafaqohen të rinjtë dhe të rejtat nga këto komunitete janë prezent një kombinim shkaktarësh. Megjithatë, mungesa e disponueshmërisë së pajisjeve qëndron të jetë një nga arsytet pse “mësimi në distancë” kishte sukses të kufizuar. Thënë shkurt, shumë familje Rome, Ashkali dhe/apo Egjiptiane nuk posedojnë pajisje, tablet apo laptop, të cilën nxënësit mund ta përdorin ndërsa janë në shtëpi. Për shembull, Admovere një organizatë jo-fitimprurëse e cila fokusohet në promovimin e arsimit në të gjithë Kosovën, ka publikuar një raport ku thuhet se rreth 51% e nxënësve të grupeve të lartëcekura në Komunën e Ferizajt nuk kanë marrë pjesë në këto programe. Si rezultat, këto statistika kanë bërë që shumë në këto komunitete të arrijnë në përfundim se mospërfshirja e nxënësve ishte për shkak të mungesës së burimeve.

Kjo situatë shqetësuese bëri thirrje qeverisë të krijojë mekanizma për të lehtësuar shpërndarjen e pajisjeve për familjet e margjinalizuara.

Kështu, akterët të cilët merren me këtë çështje duhet të sigurojnë që nxënësit të kenë pajisjet e nevojshme për këtë lloj mësimi. Të njëjtit poashtu duhet të jenë të vetëdijshëm se posedimi i një pajisje nuk mjafton. Shumë prindër përdorën burimet që kishin duke ndarë telefonat e tyre në mënyrë që fëmijët të mund të ndiqnin mësimet dhe të jenë pjesë e "mësimin nga distanca". Një studim i nxjerrë nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) theksoj se kjo marrëveshje stresuese vendosi një barrë të papërballueshme për familjet Rome, Ashkali dhe Egjiptiane. Me fjalë të tjera, mungesa e dukshme e pajisjeve shpesh bëri që shumë njerëz të besonin se këto programe mësimore nuk ishin zgjidhje praktike.

Ndërkaq këtë politikëbërësit nuk mund ta pranojnë. Investimi në pajisjeduhet të bëhet për shkollat dhe familjet me fokus në këto komunitete, meqë të pritësh që ata të përdorin atë që kanë pa ofruar mbështetje do të dëmtonte procesin e digjitalizimit të sistemit arsimor.

Megjithëse sigurimi që pajisjet të jenë në duart e nxënësve është thelbësore, zyrtarët në Kosovë duhet të bëjnë më shumë për nxënësit nga këto grupe që dëshirojnë të arsimohen. Veçanërisht, ata duhen të fillojnë duke pranuar se problemet që u shfaqën gjatë pandemisë u përkeqësuan nga shkalla e varfërisë që gjendet në këto komunitete. Joqëndrueshmëria socio-ekonomike, ndër çështjet e tjera strukturore, u citua në një raport të fundit të nxjerrë nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) mbi komplikimet më të mëdha që kufizuan iniciativat e "mësimin online" për të rinjtë në Kosovë. Pabarazitë e gjetura jashtë këtyre institucioneve, siç është diskriminimi në punësim me të cilin përballen prindërit, ndikuan në rezultatet e fëmijëve. Mbi të gjitha, politikat e zbatuara nga qeveria të fokusuar në "mësimin online" nuk llogaritën pabarazitë e përkeqësuar nga kriza. Një qasje gjithëpërfshirëse për promovimin e "mësimin online", e përqendruar në ofrimin e zgjidhjeve teknologjike të përshtatura për nevojat e komunitetit, duhet të miratohet nga akterët përkatës të fushës së arsimit.

Megjithëse “mësimi online” është formë e mësimimit që mund ta bëjë mësimin më të qasshëm, është e qartë se për të rinjtë dhe të rejtat nga komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptianë nuk ka qenë gjithmonë opsion adekuat. Si fillim, politikëbërësit duhet të luajnë rolin e tyre që ti drejtojnë burimet e nevojshme te shkollat të cilat u shërbejnë këtyre komuniteteve. Të njëjtit poashtu duhen të ofrojnë ndihmë për familjet në këto zona, duke vendosur masa që do t'u ofronin atyre mbështetje në rast se shkollat mbyllen përsëri. Përfundimisht, ndërhyrjet e shtyra nga zyrtarët duhet të jenë të zgjeruara në fushëveprimin e tyre, duke propozuar rrugë drejt digjitalizimit të sektorit arsimorë, rrugë të cilat janë praktike dhe të përshtatshme për këto komunitete.

Duke ndjekur këto hapa, ata të cilët janë në pozita me ndikim mund të sigurohen që zotimi për “mësimin online” të realizohet për të rinjtë dhe të rejtat e Kosovës, duke siguruar të drejtën në arsimim për të gjithë pavarësisht prejardhjes.





The project is co-funded by the European Union

The "Increasing Civic Engagement in the Digital Agenda – ICEDA" project is implemented by Metamorphosis Foundation (North Macedonia), Open Data Kosovo (Kosovo), e-Government Academy (Estonia), Partners for Democratic Change Serbia (Serbia), NGO 35 MM (Montenegro) and Lëvizja MJAFTI (Albania).